

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.55/2018	Data: 30.05.2018	

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 pika (d) dhe nenit 14, paragrafi 1, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008) në lidhje me nenin 11, paragrafi 4, të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 04/L-144 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës me Nr. 35/2012) dhe nenit 21 të Rregullores 23/2013 për përcaktimin e procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010, në mbledhjen e mbajtur me 30.05.2018, miratoi këtë:

P L O T Ë S I M - V E N D I M I KUVENDIT KOMUNAL NË ISTOG, 01 NR.9/2017, E DATËS 31.01.2017

1. Në pikën dy të këtij Vendimi të Kuvendit Komunal në Istog, 01 Nr.9/2017, e datës 31.01.2017, pas fjalës do të këmbëhet më pronën publike plotësohet me këtë:
2. Me pjesën e Njesisë Kadastrale, Nr. 00223-1, me sipërfaqe prej 16140 m², Zona Kadastrale Carrallukë e evidentuar si pronë shoqërore, KK. Istog, në certifikatën pronësore me numër të Referencës 3487/2018 e lëshuar më 15.05.2018, që i përgjigjet vlerës së tregut me pronën e këmbyer.
3. Pas miratimit të këtij vendimi vlerësimin e pronës që është objekt i këmbimit do ta bëjë Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme, Departamentit të Tatimit në pronë, Ministria e Financave.
4. Ky Vendim hynë në fuqi shtatë ditë pas publikimit të tij në ueb faqen e komunës. Për realizimin e tij kujdesen, Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrotjtje të Mjedisit, të Komunës së Istogut.
5. Më kopje të këtij vendimi të njoftohen Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrotjtje të Mjedisit dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.



 REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
 REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
 UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE
 Uales-Izlazna
 Nr: 01-05-39 Data 01.06.2018
 Br: Datum
 ISTOG-ISTOK

KRYESUESI I KUVENDIT,
z. Qaush Balaj

